



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 179

Tiranë – E hënë, 12 tetor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 779, datë 7.10.2020	Për shkarkimin e një anëtari të këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës..... 12437
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 7.10.2020	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të Njesisë Administrative Tiranë, të disa pronave..... 12437
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 7.10.2020	Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë, që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen..... 12444
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 7.10.2020	Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale..... 12451
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 783, datë 7.10.2020	Për miratimin e planit të veprimit 2020–2022, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020..... 12470
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 7.10.2020	Për lirin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Elbasanit..... 12497
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 7.10.2020	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi dhe sistemimi i shesheve brenda blloqeve të banimit, si dhe krijimi i hapësirave rekreative brenda tyre ‘Lagjja 8 Shkurti’”, Bashkia Fier..... 12497
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 788, datë 7.10.2020	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar te Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të objektit me sipërfaqe 644 m ² , pjesë e pasurisë me numër 11/86, në zonën kadastrale 8320, Tiranë..... 12498
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 7.10.2020	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar te Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të pasurisë 1/162, zona kadastrale 8561, Korçë..... 12499

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 790, datë 7.10.2020	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Bubq, Bashkia Krujë.....	12501
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 791, datë 7.10.2020	Për lirimimin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.....	12509
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 794, datë 7.10.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe njërive të banimit në ndërtesa (pallat), si dhe mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Vorë dhe Lezhë.....	12509

**VENDIM****Nr. 779, datë 7.10.2020****PËR SHKARKIMIN E NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES TË AGJENCISË
SHTETËRORE TË KADASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Aurora Alimadhi, anëtar i këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përfaqësues i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, shkarkohet nga kjo detyrë.

2. Marrëdhëniet financiare i ndërpriten në datën 1.10.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM**Nr. 780, datë 7.10.2020****PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË TIRANË, TË NJËSISË
ADMINISTRATIVE TIRANË, TË DISA
PRONAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të Njesisë Administrative Tiranë, të pronave me nr. 1–4 dhe 8, sipas lidhjes 1, formularëve gjithsej 2 (dy) fletë dhe planvendosjeve, bashkëlidhur këtij vendimi, për t’u përdorur në fushën e infrastrukturës dhe zhvillimit ekonomik.

2. Pronat e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, i shtohen listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njesisë Administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



PLANVENDOSJE

BASHKIA TIRANË

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

VOL. 18 FQ. 106

ZONA KADASTRALE: 8330

NR. I PASURISË: 7/70

INDEKS HARTE: IR-I-11

SHKALLA: 1:500

ADRESA E PASURISË: Rrethi: Tiranë

Q/F: Tiranë Rr/L: "Skënder Kosturi"

P/G: Shk: K: Ap:

C: PRONARI
SHITETPërgatiti: Specialisti Ing. Topograf
RAIF HALIDINI

B. KUPIZIMET

VERI: 7/62; 65; 64


JUG: 7/329; 330; 328

LINDJE: 7/87

PERENDIM: 7/67; 68; 7/69.

D: Data: Ora:

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH

KONTURI I PASURISË SË MIRATUAR ME VKB NR. 116, DATE 25.10.2019, PËR
TRANSPERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË.RRUGË: SIP. = 170 M²

LEGJENDË

1	2	3	4	5	6	7	8
X	X	X	X	X	X	X	X
4577971.36	484546.08	4577963.67	484549.49	4577973.58	484570.63	4577971.36	484571.85
4577971.36	484571.85	4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85
4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85
4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85
4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85
4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85
4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85	4577963.67	484571.85




PLAN VENDOSJE

BASHKIA TIRANË Përgatiti: Specialisti Ing. Topograf RAIF HALIDINI 	A. IDENTIFIKIMI I PASURISË ZONA KADASTRALE: <u>8160</u> NR. I PASURISË: <u>6/187</u> INDEKS HARTE: <u>TR-S-13</u> SHKALLA: <u>1: 500</u> ADRESA E PASURISË: <u>RRETHI: TIRANË</u> Q/F: <u>TIRANË</u> Rr/L: <u>"GJENERAL NIKOL'S"</u> P/G: _____ SHK: _____ K: _____ AP: _____	VOL. <u>13</u> FQ. <u>19</u>
	B. KUFIZIMET VERI: <u>6/72</u> JUG: <u>6/167, 76</u> LINDJE: <u>6/76; 2/252</u> PERENDIM: <u>6/78</u> D: Data: _____	C. PRONARI SHITET Ora: _____

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH

**KONTURI I PASURISË SË MIRATUAR ME VKB NR. 116, DATË 25.10.2019, PËR
TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË.**
 RRUGË: SIP. = 114 M²



LEGJENDË

1	X: 4575870.27
	Y: 485713.02
2	X: 4575860.47
	Y: 485716.10
3	X: 4755848.08
	Y: 485709.43
4	X: 4575831.56
	Y: 485697.53
5	X: 4575833.38
	Y: 485697.67
6	X: 4575870.27
	Y: 485713.02




PLAN VENDOSJE

BASHKIA TIRANË Përgatiti: Specialisti Ing. Topograf RAIF HALIDINI 	A. IDENTIFIKIMI I PASURISË ZONA KADASTRALE: 8160 NR. I PASURISË: 6/76 INDEKS HARTE: TR-S-13 SHKALLA: 1: 500 ADRESA E PASURISË: RRETHI: TIRANË Q/F: TIRANË Rr/L: "GJENERAL NIKOL'S" P/G: _____ SHK: _____ K: _____ AP: _____	
	B. KUFIZIMET VIERI: 6/187 JUG: 6/167; 130 LINDJE: 2/252 PERENDIM: 6/187 D: Data: _____	C. PRONARI SHTET Ora: _____

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH

**KONTURI I PASURISË SË MIRATUAR ME VKB NR. 116, DATË 25.10.2019, PËR
TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË.**

SIP. TR. = 224 M²
6/97



LEGJENDË

1	X: 4575860.47
	Y: 485716.10
2	X: 4575849.27
	Y: 485718.90
3	X: 4575827.64
	Y: 485702.29
4	X: 4575831.56
	Y: 485697.53
5	X: 4575848.08
	Y: 485709.43




PLANVENDOSJE

BASHKIA TIRANË Përgatiti: Specialisti Ing. Topograf RAIF HALIDINI 	A. IDENTIFIKIMI I PASURISË ZONA KADASTRALE: 8360 NR. I PASURISË: 7/430 VOL. 31 FQ. 230 INDEKS HARTE: TR-N-12 SHKALLA: 1:500 ADRESA E PASURISË: Rrethi: Tiranë Q/F: Tiranë Rr/L: "Barrikadave" P/G: _____ Shk: _____ K: _____ Ap: _____
	B. KUFIZIMET VERI: 7/17 JUG: 7/414 LINDJE: 7/18 PERENDIM: 7/429, 414 D: Data: _____ Ora: _____
C. PRONARI SHTET	

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH

 KONTURI I PASURISË SË MIRATUAR ME VKB NR. 116, DT. 25.10.2019, PËR
 TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË.
 TRUALL: SIP. = 29 MP.



LEGJENDË

1	X	4577320.94
	Y	484958.52
2	X	4577324.86
	Y	484960.90
3	X	4577319.68
	Y	484963.70
4	X	4577320.52
	Y	484965.80
5	X	4577318.84
	Y	484968.74
6	X	4577316.60
	Y	484967.90
7	X	4577314.50
	Y	484963.00




PLANVENDOSJE

BASHKIA TIRANË Përgatiti: Specialisti Ing. Topograf RAIF HALIDINI 	A. IDENTIFIKIMI I PASURISË ZONA KADASTRALE: <u>8150</u> NR. I PASURISË: <u>1/100</u> VOL. <u>30</u> FQ. <u>137</u> INDEKS HARTE: <u>TR-P-12</u> SHKALLA: <u>1:500</u> ADRESA E PASURISË: RRETHI: <u>TIRANË</u> RR/L: <u>"MURAT TOPTANI"</u> Q/F: <u>TIRANË</u> Rr/L: <u>"MURAT TOPTANI"</u> P/G: _____ SHK: _____ K: _____ AP: _____
	B. KUFIZIMET VERI: <u>1/98</u> JUG: <u>1/509; 507</u> LINDJE: <u>1/99</u> PERENDIM: <u>1/260; 507</u> D: Data: _____

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH

KONTURI I PASURISË SË MIRATUAR ME VKB NR. 116, DATË 25.10.2019, PËR
 TRANSFERIMIN NË PRONESI TË BASHKISË TIRANË

SIP. TR = 292.40 M²
 SIP. ND = 152.00 M²



LEGJENDË

1	X: 484957.70
	Y: 4576799.88
2	X: 484977.06
	Y: 4576801.00
3	X: 484981.40
	Y: 4576781.96
4	X: 484973.14
	Y: 4576780.14
5	X: 484970.76
	Y: 4576788.82
6	X: 484961.10
	Y: 4576786.30



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE (Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Identifikoi: Albana Hoxha(përgjegjës sektori); Raif Halidini (Specialist)

Bashkia : Tiranë

Supervizoi Alban Dokushi,Drejtor (Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit)

Fusha e përdorimit të Prones: Infrastruktura

Aprovoi: Erion Veliaj (Kryetar)

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera (Shenime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8330 L-11	7/70	Rruge	Rruge Rr. Skender Kosturi	170		rruge	Bashkia Tirane	DPNR 2PQ	Shtet- V.18, fq.106
2	8160 S-13	6/187	Rruge	Rruge Rr. Elbasanit	114		rruge	Bashkia Tirane	DPNR 2PQ	Shtet- V. 13, fq. 19
3	8160 S-13	6/76	Shesh	Shesh Rr. Elbasanit	224		shesh	Bashkia Tirane	DPNR 2PQ	Shtet- v.18, fq. 226
4	8360 N-12	7/430	Truall	Truall Rr. Barikadeve	29		hapësirë publike	Bashkia Tirane	Bashkia	Shtet- v.31, fq. 230

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE (Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Identifikoi: Albana Hoxha(përgjegjës sektori); Raif Halidini (Specialist)

Bashkia : Tiranë

Supervizoi Alban Dokushi,Drejtor (Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit)

Fusha e përdorimit të Prones: Zhvillim ekonomik

Aprovoi: Erion Veliaj (Kryetar)

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera (Shenime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
8	8150 P-11	1/100	truall+objekt	Ish Drejtoria Arsimore e Fshatit Rr. M. Shyri (sot Rr. A. Toptani)	292.4	152	Zhvillim Ekonomik Ish zyre Parti Politike	Bashkia Tirane	Bashkia Tirane	Shtet - v. 30, fq. 137



Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1–3	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e infrastrukturës (rrugë dhe sheshe).	Në pronësi
4	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e infrastrukturës (troje të lira).	Në pronësi
8	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi

VENDIM**Nr. 781, datë 7.10.2020**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
TË HOLLËSISHME TË REGJISTRIMIT
TË TITUJVE TË PRONËSISË, QË NUK
KANË TË PËRCAKTUAR SIPËRFAQEN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 30, pika 4, dhe 71, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i procedurave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen tituj pronësie në përputhje me nenin 193, të Kodit Civil, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen.

2. Për efekt të këtij vendimi, konsiderohen pasuri të paluajtshme pa sipërfaqe të përcaktuara:

a) pasuritë, për të cilat në asnjë nga aktet e fitimit apo kalimit të pronësisë nuk është shprehur sipërfaqja dhe nuk ka skicë/planvendosje shoqëruese ose, edhe nëse ka skicë/planvendosje shoqëruese, ajo ka mangësi teknike-hartografike që e bëjnë të pamundur përcaktimin e sipërfaqes;

b) pasuritë, për të cilat në aktet e fitimit të pronësisë është shprehur sipërfaqja, por nuk e ka skicën/planvendosjen shoqëruese me paraqitjen grafike të sipërfaqes përkatëse. Kjo shkronjë zbatohet vetëm kur organet administrative që kanë miratuar aktin e fitimit pronësisë janë shuar si persona juridikë publikë ose nuk janë më kompetentë për çështjen dhe nuk ka një organ tjetër administrativ kompetent për të plotësuar mangësitë e aktit.

3. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, këtu e në vijim ASHK, vepron për përcaktimin e sipërfaqes dhe kufijve të pasurisë, në përputhje me përcaktimet e nenit 30, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, gjatë procedurave të regjistrimit fillestar, gjatë procedurave të përmirësimit të të dhënave të regjistrimit kadastral apo me kërkesë të subjekteve të interesuara.

4. I nënshtrohen procedurës së përcaktimit të sipërfaqes pasuritë e paluajtshme që ndodhen, në:

a) zona kadastrale, për të cilat në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi ka përfunduar regjistrimi fillestar dhe pasuritë janë regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme me shënimin “shtet” ose “pronar i pavërtetuar” në seksionin e pronësisë. Këto pasuri regjistrohen në emër të një subjekti konkret, pasi të zhvillohet procedura e përcaktimit të sipërfaqes, në bazë të këtij vendimi;

b) zona kadastrale, për të cilat është duke u zhvilluar procesi i regjistrimit fillestar. Në këtë rast, përcaktimi i sipërfaqes është pjesë e procesit të regjistrimit fillestar;

c) zona kadastrale, për të cilat është duke u zhvilluar procesi i përmirësimit të të dhënave kadastrale. Gjatë procesit të përmirësimit kryhet procedura e plotë për përcaktimin e sipërfaqes.

**II. PROCEDURA E PËRCAKTIMIT TË
SIPËRFAQES DHE TË KUFIJVE**

5. Gjatë kryerjes së procesit të regjistrimit fillestar apo përmirësimit të të dhënave kadastrale, të nisur kryesisht nga ASHK-ja, procedura për përcaktimin e sipërfaqes dhe të kufijve për pronat pa sipërfaqe kryhet duke administruar kërkesat dhe dokumentacionin, sipas përcaktimeve dhe kushteve të pikës 4, të nenit 30, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

6. Dokumentet për përcaktimin e sipërfaqes, që administrohen gjatë regjistrimit fillestar ose përmirësimit, kanë të bëjnë me:

a) pronën që do të regjistrohet;



b) pronat kufitare dhe paraqitjen hartografike të tyre;

c) dokumente hartografike ndihmëse/orientuese sa më të hershme që mund të gjenden pranë arkivave të institucioneve që kanë lëshuar titullin e pronësisë ose arkivave të tjerë shtetërorë, nëse ka të tilla;

ç) aktin e verifikimit në terren, sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi;

d) deklaratat noteriale të pronarëve kufitarë, që vërtetojnë përmbajtjen e kërkesës për kufijtë e pasurisë që pretendohet të regjistrohet.

Kur nuk mund të merren deklaratat apo ka mosmarrëveshje me kufitarët për kufirin e pasurive, ai përcaktohet nga ASHK-ja, duke iu referuar dokumentacionit të mësipërm dhe verifikimit në terren. Në këtë rast, procedura për përcaktimin e sipërfaqes është pjesë e procesit të regjistrimit fillestar ose përmirësimit dhe kryhet duke bërë të njëjtat verifikime si pikat vijuese të këtij kreu.

7. Në zonat me regjistrim fillestar të kryer, kërkesa e subjektit të interesuar apo përfaqësuesit të tij për përcaktimin e sipërfaqes dhe kufijve duhet të shoqërohet nga:

a) titulli i pronësisë, në rastet kur pasuria e paluajtshme regjistrohet për herë të parë ose dokumenti i regjistrimit, në rastet kur pasuria e paluajtshme figuron e regjistruar në regjistrat kadastralë;

b) planvendosja, skica apo çdo dokument tjetër hartografik që shoqëron titullin e pronësisë, nëse ka të tillë, pavarësisht nëse është i pamjaftueshëm më vete, për të përcaktuar sipërfaqen, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij vendimi;

c) dokumente të tjera hartografike ndihmëse/orientuese nga Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, arkivi shtetëror ose institucionet shtetërore që kanë lëshuar titullin, nëse ka të tilla;

ç) dokumentacioni hartografik i pasurisë së paluajtshme – planrilevimi, që miratohet nga drejtoria vendore e ASHK-së;

d) deklaratat noteriale të pronarëve kufitarë, që vërtetojnë përmbajtjen e kërkesës për kufijtë e pasurisë, që pretendohet të regjistrohet.

8. Për përcaktimin e sipërfaqes, drejtoria vendore e ASHK-së kryen veprimet e mëposhtme:

a) verifikon vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesi pranë institucioneve shtetërore apo noterit;

b) kryen verifikimin në terren të pasurisë, për të cilën saktësohet sipërfaqja;

c) mbështetet për orientim në kufijtë e pronave kufitare, titujt e të cilave e kanë të përcaktuar sipërfaqen respektive.

9. Drejtoria vendore e ASHK-së, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur, duke u shprehur me vendimmarrje.

10. Në rast se gjatë shqyrtimit të kërkesës drejtoria vendore e ASHK-së konstaton se:

a) kërkesa shoqërohet me të meta, njofton kërkuesin për plotësimin e tyre brenda afatit 10-ditor. Në rast të mosplotësimit të të metave brenda afatit, drejtori vendor del me vendim mbi mospranimin e kërkesës. Kundër vendimit të mospranimit mund të ushtrohet ankim gjyqësor;

b) ka një informacion zyrtar se për të njëjtën procedurë është duke u zhvilluar një proces gjyqësor pranë gjykatës, atëherë drejtori vendor del me vendim mbi pezullimin e procedurës, deri në marrjen nga gjykata të një vendimi të formës së prerë dhe njofton kërkuesin.

11. Në rast se gjatë procedurës administrative të shqyrtimit të kërkesës, drejtoria vendore e ASHK-së konstaton se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me përcaktimet e pikës 7, të këtij vendimi, kryhet verifikimi në terren i pasurisë, objekt kërkesë. Në përfundim të verifikimit mbahet aktkonstatimi përkatës dhe hartohet planvendosja, përkatësisht sipas anekseve nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Aktkonstatimi dhe planvendosja i njoftohen subjektit. Nëse subjekti i interesuar nuk paraqet pretendime brenda 15 ditëve lidhur me pozicionimin, sipërfaqen dhe kufijtë e përcaktuar në planvendosje, ASHK-ja del me vendim për saktësimin e sipërfaqes dhe regjistrimin e pasurisë sipas kufijve të përcaktuar në planvendosje.

12. Në rast se kërkesa nuk shoqërohet nga deklaratat e pronarëve kufitarë të pasurisë, për të cilën kërkohet regjistrimi me përcaktimin e sipërfaqes, sipas shkronjës “c”, të pikës 4, të nenit 30, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, atëherë kërkuesi dorëzon një deklaratë noteriale, të nënshkruar prej tij, me të cilën vërteton në përgjegjësinë e vet se nuk ka mundur, për arsye objektive, të sigurojë deklaratën e pronarit/eve kufitar/ë, si dhe natyrën e pamundësisë objektive.



Në këto raste, si dhe kur ka mosmarrëveshje për kufirin e pasurive, drejtoria vendore e ASHK-së, pas verifikimit në terren të kësaj pasurie, harton aktkonstatimin dhe planvendosjen.

Aktkonstatimi dhe planvendosja i njoftohen subjektit të interesuar dhe afishohen për një periudhë 15-ditore në ambientet e dukshme të kësaj drejtorie dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria.

Nëse brenda këtij afati nuk paraqitet ankesë apo pretendim nga pronari/ët kufitar/ë për kufijtë e pasurisë, për të cilën kërkohet regjistrimi, atëherë miratohet vendimi nga ASHK-ja.

12.1 Në rast se brenda afatit të sipërpërmendur nga pronari/ët kufitar/ë paraqiten kundërshtime për aktkonstatimin dhe planvendosjen, drejtoria vendore e ASHK-së pezullon procedurën, deri në shqyrtimin administrativ të pretendimeve të paraqitura.

Me përfundimin e shqyrtimit administrativ miratohet vendimi sipas aneksit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, dhe planvendosja përfundimtare nga drejtoria vendore e ASHK-së, dhe vijohet me regjistrimin e pasurisë sipas sipërfaqes dhe kufijve të miratuar.

12.2 Në rast se pronarët kufitarë, gjatë afishimit 15-ditor i drejtohen gjykatës për pretendime të pazgjidhura përfundimisht lidhur me të dhënat e afishuara për caktimin e kufijve të hartuar nga drejtoria vendore e ASHK-së, atëherë kjo e fundit pezullon procedurën për pasuritë konkrete, deri në shpalljen nga gjykata të vendimit të formës së prerë.

13. Kur procedura e përcaktimit të sipërfaqes kryhet gjatë procesit të regjistrimit fillestar, afishimi 15-ditor sipas pikës 12, të këtij vendimi, është pjesë e njoftimit publik 45-ditor, të parashikuar në nenin 31, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

14. Kur pronat kufitare janë pasuri shtetëror/publike, deklarata noteriale zëvendësohet nga konfirmimi zyrtar i institucionit pronar apo që administron pronën shtetërore. Nëse identifikimi i institucionit pronar ose administrues nuk është i mundur, deklarata noteriale nënshkruhet nga bashkia, në të cilën ndodhet pasuria.

Nëse institucionet e mësipërme sipas rastit nuk nënshkruajnë deklaratën noteriale brenda afatit 30-ditor, ASHK-ja, pas kalimit të afatit, vijon procedurën.

15. Kur pronën kufitare e kanë në pronësi dy a më shumë bashkëpronarë, kërkuesi paraqet deklaratat noteriale të bashkëpronarëve, për të cilët është e mundur marrja e kësaj deklarate. Për bashkëpronarët e tjerë, për të cilët nuk është e mundur objektivisht marrja e deklaratës noteriale, zbatohen procedurat e afishimit të aktit të përcaktimit të kufirit/planvendosjes së miratuar për një periudhë 15-ditore.

16. Afati për të marrë vendim nga ASHK-ja është 30 ditë kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës. Përgjithësisht në rastet e afishimit, të parashikuar në pikën 12, të këtij vendimi, afatit për pranimin ose jo të kërkesës i shtohet edhe periudha e afishimit.

17. Vendimi për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme i njoftohet kërkuesit dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të ASHK-së. Kundër këtij vendimi subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim në gjykatë.

18. Tarifat dhe shpenzimet e tjera administrative, nëse ka të tilla, paguhet nga kërkuesi përpara mbylljes së procedurës administrative të shqyrtimit të kërkesës me vendimmarrje nga drejtoria vendore e ASHK-së.

III. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

19. Nuk janë objekt i këtij vendimi pasuritë, të cilat në aktet e tyre të fitimit të pronësisë nuk e kanë të shprehur sipërfaqen, por këto akte janë të shoqëruara me dokument hartografik, të lëshuar nga organet kompetente si shoqëruese e aktit të pronësisë, nga i cili mund të nxirret sipërfaqja e saktë e pasurisë.

20. Kur pasuria në rastet e parashikuara në krerët e tjerë të këtij vendimi është kaluar në pronësi të të tretëve, nëse të paktën njëri prej veprimeve të kalimit të pronësisë është i shoqëruar ose i plotësuar me dokumentacion hartografik që të përcaktojë sipërfaqen dhe kufijtë, ky i fundit merret i mirëqenë për efekt regjistrimi.

21. Për pasuritë e paluajtshme që kanë tituj pa sipërfaqe të përcaktuara, por që ndodhen në zona kadastrale, për të cilat ka përfunduar regjistrimi fillestar përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, merren të mirëqena sipërfaqja dhe kufijtë e tyre të pasqyruar sipas regjistrimit fillestar, pavarësisht mangësive në procedurë, dokumentacion dhe formë në raport me ligjin e kohës. Kjo me kusht që gjatë periudhës së afishimit publik të mos ketë



pasur asnjë pretendim të pazgjidhur për sipërfaqen, kufijtë dhe pozicionimin e pasurisë, evidentuar kjo në kartelën e pasurisë ose librin e pranimi të kërkesave. Për këto raste, sipërfaqja dhe kufijtë e pasqyruar në regjistrë merren të mirëqena, pa qenë nevoja për të kryer procedurën sipas pikës 4, të nenit 30, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

Në të kundërt, nëse ka pretendime të pazgjidhura nga regjistrimi fillestar, kryhet procedura e përcaktimit të sipërfaqes dhe kufirit sipas rregullave të këtij vendimi.

22. Përcaktimi i sipërfaqes në regjistrat e pasurive të paluajtshme, për pronat me titull pronësie pa sipërfaqe, të regjistruara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duke përfshirë edhe regjistrat hipotekorë, merret i mirëqenë, pavarësisht mangësive në formë, procedurë dhe dokumentacion.

Këtu përfshihen edhe regjistrimet për pronat pa sipërfaqe, të kryera deri në datën 2.4.2007, në zbatim të shkronjës “b”, të nenit 24, të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të shfuqizuar.

23. Gjithashtu, merren të mirëqena edhe përcaktimet/pasqyrimet në regjistrat e pasurive të paluajtshme të sipërfaqeve shtesë mbi sipërfaqen e shprehur në dokument, të kryera dhe të regjistruara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, pavarësisht mangësive në formë, procedurë dhe dokumentacion.

24. Kur ka pretendime për kufijtë midis pronarëve të dy apo më shumë pasurive, që kanë

tituj me sipërfaqe të papërcaktuara, sipas pikave të mësipërme, mosmarrëveshja zgjidhet në rrugë gjyqësore.

25. Përfshijmë, në rast se kufijtë apo pozicionimi në hartën kadastrale i pasurive, objekt i pikave 20, 21, 22 dhe 23, të këtij vendimi, cenojnë kufijtë ose sipërfaqen e pronave të tjera të regjistruara, titujt e të cilave i kanë qartësisht të përcaktuara kufijtë dhe sipërfaqen nga pikëpamja grafike, atëherë drejtoria vendore e ASHK-së kryen korrigjimin e kufijve sipas neneve 16 ose 35 e vijuese të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

26. Objektet e regjistruara në regjistrat hipotekorë deri në momentin e hyrjes në fuqi të dekretit nr. 4823, datë 2.3.1971, “Mbi të drejtën e pronësisë”, që nuk ka të cilësuar truallin, por vetëm kufijtë, trajtohen si pasuri me sipërfaqe të papërcaktuara, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 30, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe dispozitave të këtij vendimi.

27. Vendimi nr. 745, datë 24.10.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, shfuqizohet.

28. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
 DREJTORIA _____

(Aneks 1)

AKT KONSTATIMI

Nga verifikimi në terren të pasurisë nr. _____, e llojit _____, Zona Kadastrale, me adresë: Rruga "_____", Njësia Administrative _____ në pronësitë _____ e përfshirë në procedure sipas VKM nr. _____, datë ____/____/____ "Për procedurat e hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen", me kërkesën nr. _____ prot., datë ____/____/____, rezultoi:

TË DHËNAT E PASURISË:-Sipërfaqja e parcelës është: _____ m²

-Në sipërfaqen e parcelës ka objekt me këto të dhëna:

- Sipërfaqja e bazës (njollës) së objektit _____ m²
- Numri i kateve _____

Pasuritë kufitare:

NR.	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME

Deklaroj se sipas kufijve që i kam treguar specialistit të ASHK-së, marrëdhëniet me kufitarët janë sipas përshkrimit në planvendosjen e hartuar nga ASHK, si dhe nuk kam dijeni për konflikte apo pretendime për kufijtë.

 (emër, mbiemër, firmë) (Datë)
Verifikimi në terren u krye nga:
 Specialistët e ASHK-së _____
 (emër, mbiemër, firmë) (Datë)

 (emër, mbiemër, firmë) (Datë)

Në rast pretendimi në lidhje me kufirine pasurisë të përcaktuara nga evidenti në terren nga ASHK, duhet të depozitohet dokumenti për vërtetësin e pretendimeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA _____

Aneksi 2

PLAN VENDOSJA QE PERCAKTON SIPERFAQEN E PRONES ME TITULL PRONESIE

PRONARI _____ DATE ____/____/____

VENDNDODHJA _____ ZONA KADASTRALE _____ NUMRI PASURISE _____ INDEX HARTE _____
BASHKIA _____

TE DHENAT E PASURISE _____ SIP.PASURISE= _____ m² SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= _____ m² NUMRI KATEVE _____ NUMRI PEMIEVE _____
LLOJI PASURISE _____

X,Y _____ KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE _____ X,Y _____

N

SH 1: _____

X,Y _____ X,Y _____

SHPJEGUES

KUFIRI I SAKTESUAR I PASURISE _____ m²
KUFIRI I SAKTESUAR I NDERTESES _____ m²

Nr.	ORIENTIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME
1					
2					
3					
....					

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI _____

DVASHK _____

NENSHKRIMI _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____

Kode per teknologji e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: _____

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

KONFIRMOJ

PERGJEGJESI/DREJTORI _____

NENSHKRIMI / VULA _____

SHENIME TE VECANTA: _____



(Aneks 3)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA _____

VENDIM

Nr. _____, datë ____/____/____

PËR
PËRCAKTIMIN E SIPËRFAQES SË PASURISË ME NUMËR ____ NË ZONËN
KADASTRALE _____

Mbështetur në nenin 30 të ligjit nr.111/2018, "Për Kadastrën" dhe në zbatim të vendimit nr._____, datë _____ të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen", u mor në shqyrtim kërkesa me Nr.____ prot., datë ____/____/____, për përcaktimin e sipërfaqes dhe kufijve të pasurisë me nr.____ e llojit _____ në zonën kadastrale _____ me subject kërkuar _____.

Parashtrimi i fakteve: (Këtu do të listohen të dhënat e kërkesës, shpjegimet e situatës faktike dhe veprimet administrative të kryera nga ASHK, të dhënat e gjendjes ndërtimore dhe gjendjes juridike të pasurisë sipas regjistrave të pasurive të paluajtshme, shpjegime mbi vlerësimin e provave).

Nga verifikimet e kryera në terren rezulton se:...

Vlerësimi dhe arsyetimi ligjor: (Shpjegimet mbi kushtet dhe shkaqet ligjore për miratimin e kërkesës).

VENDOSI:

1. Përcaktimin e sipërfaqes në _____ m² dhe kufijve të pasurisë me nr.____
(në shifra dhe fjalë)
e llojit _____, në zonën kadastrale, në emër të subjektit z/zj. _____.
2. Pasuria me numër _____ sipas plan-vendosjes që shoqëron dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi, kufizohet në Veri me _____; Jug _____
Lindje _____; Perëndim _____;
3. Të dhënat mbi sipërfaqen dhe kufijtë të përcaktuara në këtë vendim, regjistrohen në regjistrin kadastral në përputhje me dispozitat e ligjit nr.111/2018, "Për Kadastrën".
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet subjekteve të interesuara brenda 5 ditëve.

DREJTOR

KY VENDIM HARTOHET NË TRE KOPJE



VENDIM
Nr. 782, datë 7.10.2020

**PËR MIRATIMIN E MODELEVE TË
AKTEVE KADASTRALE DHE TË
DHËNAVE NË PËRMBAJTJE TË
HARTËS KADASTRALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 5, 15, pika 3, dhe 17, pika 7, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky vendim ka për qëllim miratimin e mënyrës së paraqitjes (modelit) dhe të elementeve në përmbajtje të akteve kadastrale, si më poshtë vijon:

- a) kartela e pasurisë së paluajtshme;
- b) certifikata e pronësisë dhe e të drejtave reale;
- c) harta kadastrale dhe plani i rilevimit për punime kadastrale;
- ç) vërtetimi nga regjistrat e veçantë (hipotekorë ose të lejes së ndërtimit dhe karabinasë);
- d) akte të tjera kadastrale, që lëshohen nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, këtu e në vijim “ASHK”.

II. MODELI DHE PËRMBAJTJA E KARTELËS E PASURISË SË PALUAJTSHME

1. Kartela, që është fleta e regjistratit për çdo pasuri të paluajtshme, plotësohet vetëm në format elektronik, në regjistrin digjital të pasurive të paluajtshme. Proceset e regjistrimit fillestar, të përmirësimit të regjistratit dhe regjistrimi i titujve, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, si dhe çdo aktivitet kadastral, që sjell plotësim ose ndryshim të të dhënave në kartelën e pasurisë, pasqyrohen në regjistrin digjital të pasurive të paluajtshme.

2. Kartela e plotësuar në format digjital dhe e printuar nga regjistratit përbën fletën e regjistratit manual të pasurive të paluajtshme dhe vlen vetëm për administrim dhe ruajtje nga ASHK-ja, në cilësinë e dokumentacionit shkresor, në përputhje me legjislacionin për arkivat.

3. Paraqitja e kartelës së pasurisë së paluajtshme dhe elementet në përbërje të saj janë sipas aneksit

1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Kartela e pasurisë ka në përmbajtje të dhënat e parashikuara në nenin 13, pika 3 e vijues, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, të organizuara në gjashtë seksione, si vijon:

a) Seksioni A, “Të dhënat e pasurisë”, përmban të dhënat sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “e”, të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, numrin e pemëve dhe kodin unik të pasurisë.

b) Seksioni B, “Të dhënat e titullit të pronësisë”, përmban të dhënat sipas shkronjave “ç” dhe “d”, të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

c) Seksioni B/1, “Të dhënat e regjistrimit paraprak”, përmban të dhënat e titullit të pronësisë dhe të titullarit në fazën e regjistrimit paraprak, sipas pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

ç) Seksioni C, “Të drejtat reale”, përmban të dhënat për të drejtat e të tretëve mbi pasurinë, sipas shkronjave “dh” dhe “ë”, të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”. Këtu pasqyrohen vetëm ato të drejta të të tretëve, që nuk kufizojnë tagrin e disponimit.

d) Seksioni D, “Kufizimet e pronësisë”, përmban të dhëna për të drejtat e të tretëve mbi pasurinë, sipas shkronjës “dh”, të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, që kufizojnë tagrin e disponimit. Këtu pasqyrohen edhe të dhënat për çdo akt tjetër që kufizon këtë tagër, siç janë kufizimet e përcaktuara në nenin 27, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

dh) Seksioni E, “Informacione të tjera për pronën”, përmban çdo të dhënë tjetër me karakter informues dhe jothelbësor apo kufizues mbi pronësinë, pavarësisht natyrës së aktit ose dokumentacionit ligjor që shërben si burim i këtij informacioni, sipas kuptimit të shkronjës “f”, të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

e) Seksioni F, “Veprimet me kartelën e pasurisë”, përmban të dhëna identifikuese për punonjësit që kanë kryer veprime me kartelën e pasurisë së paluajtshme. Ky seksion i modelit të kartelës është pjesë e sistemit digjital të pasurive të paluajtshme, por nuk është publik dhe nuk përfshihet në dokumentin elektronik që u vendoset në dispozicion të tretëve.



Krahas të dhënave, sipas seksioneve të mësipërme, kartela përmban rubrikat për identifikimin e titullarit (drejtor), që lëshon dokumentin, së bashku me nënshkrimin elektronik, vulën elektronike dhe kodin QR (*Quick Response*).

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, nëse gjatë ofrimit të një shërbimi për pasurinë, ASHK-ja konstaton se të dhënat ose veprimet e mëparshme me pasurinë nuk janë pasqyruar në regjistrin digjital, ajo është e detyruar që t'i mbartë dhe t'i pasqyrojë ato, menjëherë në regjistrin digjital. Këtu përfshihet digjitalizimi edhe i kartelave të mëparshme nga të cilat ka prejardhjen kartela e fundit.

6. Plotësimi i të dhënave në format digjital kryhet edhe për pasuritë në zonat kadastrale, për të cilat nuk është kryer regjistrimi fillestar, duke mbartur të gjitha të dhënat mbi pasurinë që gjenden në regjistrat e veçantë manualë që janë përdorur për këto zona. Në këtë rast, kartela digjitale është jopërfundimtare dhe nuk përbën fletën e regjistrit të pasurive të paluajtshme, sepse nuk është produkt i regjistrimit fillestar sipas kreut V, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën". Modeli i kartelës jopërfundimtare është sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Numri i pasurisë, në këto raste, vendoset sipas rendit të paraqitjes së dokumenteve pranë drejtorisë vendore të ASHK-së.

III. HARTA KADASTRALE DHE MODELI I PLANIT TË RILEVIMIT

7. Harta kadastrale përmban këto të dhëna:

- kufirin e zonës kadastrale (ZK);
- numrin e zonës kadastrale dhe sipas rastit emrin e zonës kadastrale;
- kufirin e pasurisë së paluajtshme;
- numrin e pasurisë së paluajtshme, i cili është unik brenda një zone kadastrale;

Kufijtë dhe pozicioni gjeografik i pasurive në hartën kadastrale shprehet sipas Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare.

8. Harta kadastrale plotësohet dhe ruhet në format elektronik, në sistemin e regjistrit digjital të pasurive të paluajtshme.

9. Harta e printuar nga regjistri digjital i pasurive të paluajtshme përbën kopjen manuale të hartës kadastrale dhe vlen vetëm për administrim dhe ruajtje nga ASHK-ja, në cilësinë e dokumentacionit shkresor, në përputhje me legjislacionin për arkivat.

10. Fragmenti i hartës kadastrale është ekstrakti i kësaj harte që pasqyron pozicionin dhe kufijtë e një ose disa pasurive. Modeli i fragmentit të hartës kadastrale është sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11. Plani i rilevimit për punime kadastrale është dokumenti hartografik që hartohet si rezultat i verifikimeve dhe i matjeve në terren të pasurisë së paluajtshme. Ai pasqyron gjendjen faktike të pasurisë dhe hartohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës ose nga një inxhinier gjeodet i licencuar. Modeli i planit të rilevimit për punime kadastrale është sipas aneksit 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12. Kur plani i rilevimit hartohet nga eksperti gjeodet i licencuar, ky i fundit, për identifikimin e pasurisë, duhet të marrë dokumentacionin dhe informacionin kadastral. Plani i rilevimit duhet të përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", dhe duhet të dorëzohet në çdo rast në format shkresor dhe digjital.

13. Plani i rilevimit për punime kadastrale, i hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, i nënshtrohet kontrollit dhe konfirmimit nga ASHK-ja, për standardet teknike.

14. Fragmenti i hartës kadastrale dhe plani i rilevimit për punime kadastrale të hartuar nga ASHK-ja plotësohen, nënshkruhen, vulosen dhe lëshohen elektronikisht, si dokumente elektronike. Kopjet e printuara të tyre arkivohen si dokument shkresor, në përputhje me legjislacionin për arkivat.

15. Për zonat kadastrale, ku harta kadastrale është e administruar në sistemin digjital të pasurive të paluajtshme, nëse gjatë ofrimit të një shërbimi për pasurinë, drejtoria vendore e ASHK-së konstaton nga verifikimi i dokumentacionit teknik dhe hartës kadastrale, se veprimet e mëparshme hartografike nuk janë pasqyruar në hartën kadastrale digjitale, ajo është e detyruar që t'i pasqyrojë ato menjëherë, përpara se të realizojë shërbimin.

16. Për zonat kadastrale ku ka përfunduar regjistrimi fillestar por harta kadastrale nuk është administruar në sistemin digjital të pasurive të paluajtshme, veprimet në hartën kadastrale vijnë në kryhen në planshetat në format manual, të



krijua përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, deri në administrimin në sistemin digjital të pasurive, si produkt i procesit të digjitalizimit, nëse është rasti i përmirësimit/përditësimit.

Në këtë rast, ofrimi i shërbimit të fragmentit të hartës bëhet në rrugë, sipas pikës 15, të këtij vendimi, pas hartimit, skanimit dhe ngarkimit në rrugë digjitale, të fragmentit të planshetës manuale.

17. Përfundimisht, në rastet e pikës 17 të këtij vendimi, kur gjatë trajtimit të kërkesës për shërbim, drejtoria vendore e ASHK-së konstaton se kufijtë e pasurisë së paluajtshme nuk janë të pasqyruar saktë sipas aktit të pronësisë dhe faktit, ajo vepron, si më poshtë:

Kryen korrigjimin, sipas nenit 16, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, vetëm për pasurinë, objekt i kërkesës për shërbim, duke e pasqyruar atë të saktësuar, sipas planit të rievimit në sistemin digjital të pasurive të paluajtshme. Veprimet vijuese mbi këtë pasuri kryhen vetëm në format digjital. Kur konstatohet se korrigjimi nuk është i mundur, për shkak të dokumentacionit të paplotë, ASHK-ja njofton aplikuesin për plotësimin e dokumentacionit, sipas pikës 26 të këtij vendimi. Në rast mosplotësimi të dokumentacionit, shërbimi do të mund të realizohet vetëm pas përfundimit të procesit të përmirësimit, sipas kreut VI, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

18. Përfundimisht, për zonat kadastrale ku nuk është kryer ende regjistrimi fillestar, pasqyrimi i të dhënave hartografike të titujve të pronësisë kryhet në një modul digjital të veçantë, unik për të gjithë Republikën e Shqipërisë, të modeluar sipas kornizës referuese gjeodezike shqiptare. Produkti hartografik i krijuar nëpërmjet këtij moduli është jopërfundimtar dhe nuk përbën hartën kadastrale, e cila krijohet vetëm pas përfundimit të regjistrimit fillestar, në bazë të nenit 32, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

IV. CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT TË PRONËSISË DHE E TË DREJTAVE REALE

19. Certifikata ka për qëllim të vërtetojë faktin e regjistrimit të titullit të pronësisë apo të së drejtës reale, në bazë të nenit 17, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”. Lëshimi i certifikatës nuk përbën titullin e pronësisë apo të së drejtës reale nga ana thelbësore dhe e përmbajtjes.

20. Modeli i certifikatës së regjistrimit të pronësisë është sipas aneksit 5, që i bashkëlidhet

këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Ai përbëhet nga këto rubrika:

a) Të dhënat mbi pronarin/bashkëpronarët:

- emri i plotë i pronarit/bashkëpronarëve (emër, atësi, mbiemër ose emri i personit juridik);
- numri personal ID ose NIPT (për personat juridikë);

- pjesët takuese të bashkëpronësisë (kur pasuria është në bashkëpronësi).

b) Të dhënat përshkruese mbi pasurinë e paluajtshme:

- numri i pasurisë;
- kodi unik i pasurisë;
- zona kadastrale;
- lloji i pasurisë;
- sipërfaqja e pasurisë;
- vlera e pasurisë;
- adresa e pasurisë.

c) Të dhënat e dokumentit dhe të sigurisë të certifikatës janë, si më poshtë vijon:

- data e lëshimit të certifikatës;
- numri serial i certifikatës, unik për të gjithë Republikën e Shqipërisë;
- titullari i institucionit;
- kodi i sigurisë QR (*Quick Response*);
- nënshkrimi dhe vula elektronike.

21. Modeli i certifikatës së regjistrimit të të drejtave reale është sipas aneksit 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Ai përbëhet nga këto rubrika:

a) Lloji i së drejtës reale, që plotësohet në titullin e certifikatës.

b) Të dhënat mbi titullarin e së drejtës reale:

- cilësia e titullarit (qiramarës, enfiteozëmarrës, uzufuktat, përdorues, kreditor hipotekor etj.);
- emri i plotë i titullarit (emër, atësi, mbiemër ose emri i personit juridik);

- numri personal ID ose NIPT (për personat juridikë).

c) Të dhënat përshkruese mbi pasurinë e paluajtshme dhe afatin e së drejtës:

- numri i pasurisë;
- kodi unik i pasurisë;
- zona kadastrale;
- lloji i pasurisë;
- sipërfaqja e pasurisë;
- sipërfaqja ose pjesa takuese e pasurisë, që është objekt i së drejtës reale;
- afati i së drejtës reale;



- numri identifikues i fragmentit të hartës kadastrale;

- adresa e pasurisë.

ç) Të dhënat mbi pronarin/bashkëpronarët:

- emri i plotë i pronarit/bashkëpronarëve (emër, atësi, mbiemër ose emri i personit juridik);

- cilësia e tij në marrëdhënien e detyrimit (qiradhënëse, uzufruktdhënëse, enfiteozëdhënëse, debitor etj.);

- numri personal ID ose NIPT (për personat juridikë);

- pjesët takuese të bashkëpronësisë (kur pasuria është në bashkëpronësi).

d) Të dhënat e dokumentit dhe të sigurisë së certifikatës janë si vijon:

- data e lëshimit të certifikatës;

- numri serial i certifikatës, unik për të gjithë Republikën e Shqipërisë;

- titullari i institucionit;

- kodi i sigurisë QR (*Quick Response*);

- nënshkrimi elektronik i titullarit;

- vula elektronike.

22. Certifikata hartohet dhe miratohet si dokument elektronik dhe një kopje e printuar e saj ruhet në përputhje me legjislacionin për arkivat.

23. Në rastin e bashkëpronësisë, si dhe kur e drejta reale i përket njëkohësisht dy ose më shumë titullarëve, certifikatat lëshohen në aq kopje sa janë bashkëpronarët ose bashkëtitullarët e së drejtës reale.

V. AKTE TË TJERA KADASTRALE

24. Vërtetimet e lëshuara për pasuritë, në një zonë kadastrale që nuk i është nënshtruar regjistrimit fillestar, janë sipas anekseve 7 dhe 8, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë përbërëse të tij. Këto vërtetime nuk provojnë regjistrimin në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, për sa kohë nuk është kryer regjistrimi fillestar sipas kreut V, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

25. Vërtetimet e regjistrimit në regjistrat e veçantë të lejes së ndërtimit dhe të karabinasë janë sipas anekseve 9 deri në 12, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

26. Kur dokumentacioni i detyrueshëm i përcaktuar në ligj ose në aktet nënligjore për realizimin e një shërbimi kadastral nuk paraqitet i plotë nga subjekti kërkues i shërbimit, atëherë ASHK-ja harton kërkesën për plotësim dokumentacioni. ASHK-ja mund të bëjë vetëm një kërkesë për plotësim dokumentacioni, për një

shërbim dhe në rast se subjekti përfitues i shërbimit nuk plotëson dokumentacionin ligjor të detyrueshëm brenda 30 (tridhjetë) ditëve, ky shërbim refuzohet. Modeli i kërkesës për plotësim dokumentacioni është sipas aneksit 13, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

27. Modelet e akteve, sipas pikave 25, 26 dhe 27, të këtij vendimi, plotësohen dhe miratohen vetëm në format digjital, si dokumente elektronike dhe një kopje e printuar e tyre ruhet në përputhje me legjislacionin për arkivat.

